



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 17.02.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I PIKËS SË  
KALIMIT TË PËRBASHKËT MORINË-VËRMICË”, BASHKIA KUKËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i pikës së kalimit të përbashkët Morinë-Vërmicë”, Bashkia Kukës, me subjekt kërkues Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA





**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**



**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**